



Datë: 14.04.2026

A.nr.274/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.274/2026, të datës 10.03.2026, të parashtruar nga ankuesi G.N, më objekt ankimor “*kundërshtim i vlerësimit të rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.04.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**Hedhet poshtë si e palejuar** ankesa me numër A.nr.274/2026, e datës 10.03.2026, e parashtruar nga ankuesi G.N.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civile G.N (*tutje referuar ankuesi*), më datë 10.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2025, sipas formularit të datës 20.02.2026 dhe shkelje tjera administrative dhe ligjore.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:* Ankesën e datës 10.03.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; ID identifikuese e ankuesit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 02.02.2026; Akt Emërimit të datës 20.05.2024.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankesa është **e palejuar**, sepse:

Ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 20.05.2024, është i punësuar në pozitën *Administrator i lartë për baza të të dhënave* në Departamentin e Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative/ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Tutje, bazuar në detyrimin ligjor sipas nenit 52 të LZP, Udhëheqësi i Divizionit për Teknologji Informative, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt më datë 02.02.2026, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin sipas nivelit të përgjithshëm të vlerësimit “*arrin pritshmërinë*”.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2025 si dhe shkelje tjera administrative-ligjore. Shton së vlerësimi për vitin 2025 është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit për zyrtarë publikë pasi që mungon përshkrimi i detyrave të punës, për vitin 2024, nuk i është bërë vlerësim i rezultateve në punë edhe pse në vitin 2024 ka qenë edhe koordinatori i IT-së në Regjionin e Anamoravës dhe anëtar i Komisionit Komunal të Komunës së Vitisë në REKOS 2024, se i njëjti është diskriminuar lidhur me koeficientin e pagës pasi që nuk është trajtuar sipas rregullores për gradimin e specializuara të IT-së. Kërkon anulimin e Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në punë për vitin 2025 për shkak të mungesës së përshkrimit të detyrave të punës, të urdhërojë institucionin që të nxjerrë përshkrimin e detyrave të punës lidhur me pozitën e ankuesit si dhe të konstatoj shkeljet për mos vlerësimin e vitit 2024.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranushmërisë së ankesës lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025, iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (tutje LZP) që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, me theks të veçantë nën 52 me të cilin është përcaktuar se: “...2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; **13.3. arrin pritshmëritë;** 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme. 14. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafëve 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, për përmirësimin e aftësive profesionale, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, miraton trajnimet e detyrueshme, që nëpunësja/i duhet t'i ndjekë vitin që vjen dhe sipas vlerësimit mund të ofrojë edhe rekomandime për transferimin me qëllim të përmirësimit të rezultateve të punës. 15. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. përpos trajnimeve të detyrueshme, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, vendos që nëpunësja/i civil i nënshtrohet një vlerësimi të veçantë. 17. **Nëpunësja/i civil e cila nuk është e kënaqur me vlerësimin si në paragrafin 13. nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK, sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”.**

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe nenin 14 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, më të cilin nen përcaktohet: 1. *Nëpunësi civil i pakënaqur me vlerësimet “e papranueshme” dhe “ka nevojë për përmirësim” ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve.*

Andaj, në kuptim të kuadrit ligjor si me lart dhe duke qenë së ankuesi për vitin 2025 është vlerësuar më nivelin e përgjithshëm “*arrin pritshmërinë*”, Kolegji i Këshillit konstaton së ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse, siç përcaktohet me dispozitat ligjore si me sipër e drejta e kundërshtimit më ankesë si mjet i rregullt juridik lejohet vetëm në rastet e vlerësimit më nivel “*ka nevojë për përmirësim*” dhe “*e papranueshme*”. Kështu që, mbi këto rrethana ankesa mbi këtë bazë të pretendimit është e palejueshëm në vështrim të dispozitave të nenit 52, paragrafi 17, ndërlidhur me nenin 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përshihet se: “*1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji.*

Përkritazi me pretendimet për mos vlerësim të rezultateve në punë për vitin 2024, Kolegji referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ( tutje LPPA), me theks të veçantë nenit 98, paragrafi 1 dhe 2, Nenit 124 dhe Nenit 127, ku përcaktohet se: **Neni 98** 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.....***Neni 124** 1. *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...,* **Neni 127** : 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ... 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”.* dhe si rrjedhojë duke bazuar në këtë përcaktim ligjor si dhe duke qene së ankesa i referohet vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2024, Kolegji konstaton së ankesa e ankuesit lidhur me këtë pretendim ankimor është e jashtë afatshme, sepse, në rast së ankuesi nuk ka pranuar vlerësim të rezultateve në punë për vitin 2024 deri me datë 28 shkurt 2025, atëherë, i njëjti brenda afatit prej 30 ditësh nga data kur mbikëqyrësi i tij ka qenë i detyruar të bëjë vlerësimin, është dashur të parashtrij ankesë në Këshill për mos përfundim të vlerësimit të rezultateve në punë si një nga detyrimet ligjore të mbikëqyrësit të nëpunësit civil të përcaktuar më nenin 52 të LZP, kështu që, ankesa lidhur me këtë pretendim është parashtruar në kundërshtim me afatin ligjor sipas nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 të LPPA-së dhe si e tillë konsiderohet e pranueshme sipas nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të LPPA-së.*

Referuar pretendimit ankimor për diskriminim lidhur me koeficientin e pagës pasi që nuk është trajtuar sipas rregullores për gradimin e specializuara të IT-së dhe pretendimit për mos përshkrim të detyrave të detyrave të punës, Kolegji në kuptim të bazës ligjore si më sipër rithekson faktin së nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme te cilat burojnë nga marrëdhënia e punës, mirëpo, nëpunësi civil/ankuesi fillimisht duhet t’i drejtohet organit të punësimit më kërkesë për realizimin e të drejtës se pretenduar, dhe vetëm kundër aktit për refuzimin e kërkesës apo heshtjes se organit publikë në raport me kërkesën e parashtruar, mund të parashtrij ankesë sipas afateve të përcaktuara me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me lartë e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
A.nr.274/2026

**Merlinda RAMAJ**

*Procesmbajtëse*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit, G.N;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.